

## **BFI TRADE SHPK**

### **Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

---

#### **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

BFI Trade Sh.p.k (“Shoqëria”) u themelua si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 15 dhjetor 2015 me aktivitet kryesor tregtimin e mineraleve dhe mallrave të tjerë të ndryshëm industrialë me shumicë dhe pakicë si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Adresa e Shoqërisë është Tiranë, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndërtesa Nr. 12, Kati 11, Zyra 1206.

Shoqëria zotërohet 100% nga Balfin Sh.p.k. Nga 01 Dhjetor 2021 Shoqëria administrohet nga Z. Endri Madhi sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme më datë 30.11.2021. Përpara kësaj date shoqëria drejtohej nga Z.Erion Cinaj.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 ishte 2 punonjës (2020: 2 punonjës).

#### **2. BAZA E PËRGATITJES DHE PËRPUTHSHMËRISË**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”), të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike, shprehur në Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe.

#### **3. GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, VLERËSIME DHE SUPOZIME**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime. Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në ato pasardhëse të ndikuara nga ky ndryshim. Në veçanti, informacioni mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve të rëndësishme në aplikimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumën e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar më poshtë.

##### ***Të ardhurat nga kontratat me klientët***

Shoqëria aplikoi gjykimet e mëposhtme të cilat ndikojnë në mënyrë të rëndësishme në përcaktimin e shumës dhe kohën për njohjen e të ardhurave nga kontratat me klientët:

##### *i) Klasifikimi i shoqërisë si Kryesor apo Agjent*

Në zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit Shoqëria vlerëson nëse në kontratat me klientët, ajo luan rolin e Kryesorit apo Agjentit. Ky vlerësim bëhet në nivelin e kontratës apo grupit të kontratave të ngjashme. Bazuar në termat e kontratës, Shoqëria mund të luajë ose Kryesorin ose Agjentin, megjithëse tregton vetëm një produkt.

Gjatë vitit 2021 dhe 2020 dhe periudhave krahasuese, Shoqëria ka dalë në përfundimin se ajo plotëson kriteret e Agjentit për kontratat e kryera gjatë vitit për arsyt e mëposhtme:

- Shoqëria nuk zotëron kontrollin e kromit përpara sesa ai të transferohet tek klienti. Ajo merr të drejtën ligjore të kontrollit të kromit vetëm përkohësisht para se titulli të transferohet tek klienti, kjo pasi procesi i shitblerjes finalizohet brenda një kohe të shkurtër;
- Risqet dhe përfitimet në rast të humbjes, dëmtimit të mineralit, mosplotësimi i kriterëve të cilësisë, lagështirës, franksionimit apo sasisë nuk janë në përgjegjësinë e Shoqërisë por të klientit. Ky risk vlerësohet të jetë shumë i ulët, kjo për arsyen se sasia e kromit depozitohet drejtpërdrejt në sheshet e magazinimit të cilët ndodhen brenda ambienteve në të cilat ushtron aktivitetin klienti;

**3. GJKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, VLERËSIME DHE SUPOZIME (VAZHDIM)**

- Klienti gëzon të drejtën e kthimit të mineralit në rastet e mospërmbushjes së pikave të mësipërme të cilat janë pjesë thelbësore e kontratave, por Shoqëria në përgjithësi nuk procedon me blerjen e mineralit nëq nuk ka marrë paraprakisht pëlqimin e klientit. Cilësia e kromit që blihet nga palët e treta verifikohet paraprakisht nga Shoqëria me qëllim që të përmbushë specifikimet e cilësisë të paracaktuara nga kërkesa e klientit, si rrjedhojë Shoqëria nuk mbart rrezikun e kthimit të mineralit;
- Përcaktimi i çmimit me palën blerëse bëhet nëpërmjet negocimit të çmimit mes shitësit dhe Shoqërisë, pa ndërhyrjen e klientëve të saj. Pra Shoqëria ka njëfarë fleksibiliteti në caktimin e çmimeve në mënyrë që të gjenerojë të ardhura shtesë nga shërbimi i ndërmjetësimit i mallrave që duhet të ofrohen nga palët e tjera për klientët.

Përsa më sipër Shoqëria i një të ardhurat në formën e të ardhurave nga komisionet e cila është shuma neto midis shumës që Shoqëria i paguan furnitorit dhe shumës që i faturon klientit.

Gjatë vitit Shoqëria nuk ka pasur transaksione shitjeje me klientë ku luan rolin e primarit dhe jo të agentit.

***Parimi i vijmësisë***

Shpërthimi i pandemisë COVID-19 dhe masat e miratuara nga qeveria e Shqipërisë për të zbutur përhapjen e pandemisë kanë ndikuar në Shoqërinë. Këto masa kërkuan që Shoqëria të kufizojë aktivitetin gjatë vitit. Kjo ka ndikuar negativisht në performancën financiare të Shoqërisë për vitin dhe gjithashtu pozicionin e saj të likuiditetit.

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, Shoqëria njohu një fitim neto prej 208,711,771 Lek (31 dhjetor 2020: humbje neto prej 10,271,079 Lek). Aktivet afatshkurtër neto të Shoqërisë në 31 Dhjetor 2021 ishin 135,621,837 Lek, (31 Dhjetor 2020: (10,270,079) Lek).

Bazuar në pozicionin e likuiditetit të Shoqërisë në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, si dhe në pasigurinë që rrethonë vazhdimësinë e ardhshme të shpërthimit pandemik, drejtimi vlerëson se nuk ka nevojë për financim shtesë për të përmbushur detyrimet e saj financiare. Ekziston ende një pasiguri e rëndësishme se si pandemia do të ndikojë në biznesin e Shoqërisë në periudhat e ardhshme.

Kufizimet dhe rregulloret e COVID-19 kanë ndryshuar gjatë gjithë periudhës bazuar në përhapjen e virusit në Shqipëri. Që nga data e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, është e vështirë të vlerësoh kufizimet e mundshme që do të zbatohen në Shqipëri, dhe si rezultat, është e vështirë të përgatitësh një gamë të mundshme skenarësh për çdo ndikim të mundshëm në operacionet e Shoqërisë për periudhat e ardhshme. Megjithatë, ka ende paqartësi se si zhvillimi i ardhshëm i shpërthimit pandemik do të ndikojë Shoqërinë, menaxhmenti ka një besim të arsyeshëm se ajo ka burime të përshtatshme për ti përballuar.

Drejtimi i Shoqërisë, është duke shqyrtuar mundësinë e mbylljes së aktivitetit të biznesit të BFI Trade përgjatë vitit 2022. Për këtë, Drejtimi i Shoqërisë nuk ka zhvilluar aktivitet tregtar gjatë muajve të parë të vitit 2022, dhe është duke ndjekur likuidimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve.

Në këtë mënyrë edhe të gjithë zërat e pasqyrës së pozicionit fillestar janë riparaqitur për vitin 2020 si afatshkurtër dhe në konsistencë me vitin 2021 dhe në linjë me atë që Drejtimi i Shoqërisë do të realizojë përgjatë vitit 2022. Në gjykojmë se efektet e mundshme të ndryshimeve nga vlera e mbetur e këtyre aktiveve në atë të vlerësuar me vlerën e drejtë nuk do të kishte ndonjë ndikim material në paraqitjen e këtyre pasqyrave financiare.

## **BFI TRADE SHPK**

### **Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

---

#### **4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**

Polikat kontabël si më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjithë periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

##### **a. Transaksione në monedhë të huaj**

Regjistrimet kontabël të Shoqërisë përgatiten në Lek (ALL), që është monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku operon Shoqëria. Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në monedhën Lek, duke aplikuar mbi monedhën e huaj kursin e momentit të këmbimit të kësaj monedhe me Lek-un në datën e veprimit. Aktivet monetare dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e raportimit të pasqyrave financiare konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja/pagesa e mjeteve monetare ose nga konvertimi i mjeteve monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga ato që janë përdorur në njohjen fillestare gjatë periudhës ushtrimore aktuale ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim ose humbje e periudhës ushtrimore kur ndodh diferenca. Mjetet jo-monetare që njihen me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e veprimit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë janë të vlerësuar me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është vendosur. Diferencat e këmbimit nga rivlerësimi në datën e bilancit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 vijnë si më poshtë:

<b>Monedha</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
EUR/LEK	120.76	123.7
USD/LEK	106.54	100.84

##### **b. Instrumentat financiarë**

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiarë jo-derivativë të Shoqërisë përbëhen nga të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, paratë dhe ekuivalentët e tyre, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera, të arkëtueshme dhe të pagueshme nga njësitë ekonomike të grupit. Gjatë periudhave të raportimit nuk ka investime në letrat me vlerë të kapitalit dhe të borxhit të përdorura gjatë aktiviteteve.

##### **Aktivët Financiare**

###### *i) Njohja dhe matja fillestare*

Aktivët financiarë klasifikohen, në njohjen fillestare, me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) dhe vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar dhe nga modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre. Shoqëria mat një aktiv financiar me vlerën e drejtë të tij plus koston e transaksionit, kjo në rastin e një aktiviteti financiar të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe të matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, ajo duhet të krijojë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit (SPPI) për shumën kryesore të papaguar. Ky vlerësim quhet test SPPI dhe kryhet në nivel instrumenti financiar.

## **BFI TRADE SHPK**

### **Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

---

#### **4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

Modeli i biznesit i Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve financiare i referohet mënyrës se si ajo menaxhon aktivet e saj financiare në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare. Shoqëria ka aktive financiare të arkëtueshme tregtare nga të cilat pret vetëm arkëtimin e principalit dhe interesit në rast se aplikohet.

##### *ii) Matja e mëpasshme*

Për qëllime të matjes së mëpasshme, aktivet financiare klasifikohen në katër kategori:

- Aktive financiare me koston e amortizuar (instrumentat e borxhit);
- Aktive financiare me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse me qarkullim të fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentat e borxhit);
- Aktive financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse pa qarkullimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative në momentin e çregjistrimit (instrumentat e kapitalit neto);
- Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

##### *Aktivet financiare me koston e amortizuar*

Aktivet financiare maten me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes së mjeteve financiare për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe
- kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar të japin rritje në data të përcaktuara flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.

Të gjitha aktivet financiare të Shoqërisë maten me koston e amortizuar, dhe nuk ka aktive në klasat e tjera.

##### *iii) Çregjistrimi*

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivitetit financiar, janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon dhe as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar.

Shoqëria mund të bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

##### *iv) Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Shoqëria merr parasysh supozimin e SNRF se një aktiv financiar konsiderohet borxh i keq kur pagesat kontraktuale janë 90 ditë me vonesë, megjithatë gjykimi bëhet rast pas rasti në varësi të kërkesave të likuiditetit të palëve të lidhura. Një aktiv financiar hiqet nga librat kontabël kur nuk ka pritshmëri të arsyeshme për arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale.

## **BFI TRADE SHPK**

### **Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

---

#### **4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

##### **Aktivitet Financiare (vazhdim)**

BFI Trade shpk ka ndërtuar një model testimi për SPPI Test për llogaritë e saj në mënyrë që të bëjë klasifikimin përkatës të tyre sipas SNRF 9. Modeli i biznesit të BFI Trade lidhur me Instrumentat Financiare është “Collect Only”. Për pasqyrat financiare të vitit 2021, Shoqëria rezulton që të mos ketë asete financiare për të cilat vlerëson që të bëhet SPPI Test.

Përsa i përket zhvlerësimit të klientëve, Shoqëria bën parashikime për klientin e vetëm në baze të komunikimeve dhe informacionit të marre si pjesë e grupit. Nëse vlera e skontuar e flukseve të parashikuara të pagesave, nëse ato janë me vonë se një vit, është me e vogël se gjendja kontabel, shoqëria njihet një provigjion humbjeje.

Shoqëria në 31 Dhjetor 2021 ka gjendje klientë prej 195,033,925 Leke (2020: 2,291,706 Leke), gjendje që i përket klientit të saj kryesor Albchrome shpk, i cili për vitin 2020 ka qenë palë e lidhur. Duke qenë se aktiviteti i Shoqërisë BFI Trade është përqëndruar kryesisht në klientin e saj kryesor Albchrome shpk, i cili me anë të vendimit të Asamblesë së Ortakëve i datës 15.10.2021, ka vendosur, miratimin e shitjes së 100% të kuotës nga “Balfin - Balkan Finance Investment Group”, të shoqëria “Yildirim International Mining Investments B.V.” Transaksioni i shitjes është realizuar dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më 28.01.2022. Kështu që tashmë Albchrome shpk, nuk është më palë e lidhur me Shoqërinë BFI Trade, kjo shumë është paguar në datën 11.01.2022 në vlerën e plotë, e për këtë arsye Shoqëria ka vlerësuar se nuk ka tregues për zhvlerësim në lidhje me të arkëtueshmet ndaj klientit të saj më 31 dhjetor 2021.

Shoqëria BFI Trade vlerëson me siguri të lartë që do arkëtojë llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura pa vonesa të qenësishme, pasi ka njohuri dhe besim të plotë në aftësinë paguese të kompanisë palë të lidhur, por mbi të gjitha të vetë grupit. Si rrjedhojë Shoqëria ka vlerësuar që nuk ka rrezik zhvlerësimi, si edhe humbja e pritshme e kredisë (“ECL”) është jomateriale.

##### *Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga vlera monetare në banka dhe në arkë. Për qëllime të pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga paraja dhe depozitat afatshkurtra të përcaktuara më lart, pasi i zbritet teprica e overdrafteve bankare.

##### **Detyrimet Financiare**

###### *i) Njohja fillestare dhe matja*

Detyrimet financiare klasifikohen në njohjen fillestare si detyrime financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kreditë dhe huamarrjet, të pagueshme ose si derivativë të përcaktuar si instrumentë mbrojtës në një mbrojtje efektive, sipas rastit.

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e huave dhe të pagueshmeve, neto nga kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen. Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë detyrimet tregtare, të tjera të pagueshme dhe detyrime të tjera financiare të cilat janë të gjitha të klasifikuara si të mbajtura me kosto të amortizuar.

###### *ii) Matjet e mëvonshme*

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:

#### **4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

##### **Detyrimet Financiare (vazhdim)**

- detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes
- me kosto të amortizuar.

Shoqëria nuk mban asnjë detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes, dhe nuk ka ndonjë hua apo huamarrje.

##### *iii) Çregjistrimi*

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shlyhen, anulohen ose shuhen. Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet një detyrim financiar i ri, me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara. Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet si fitim ose humbje.

##### **c. Provigjonet**

Provigjoni njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose strukturor dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohej një dalje burimesh e shprehur me përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin, e cila mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provigjonet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim.

##### **d. Përfitimet e punonjësve**

*Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe pensionet*

Shoqëria në rrjedhën normale të aktivitetit të saj kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e paguara nga Shoqëria regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (fitim ose humbje) kur ndodhin.

##### **e. Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet në vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

##### **f. Aktivet afatgjata materiale**

###### *i) Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar.

Programet kompjuterike të blera, të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjes përkatëse, kapitalizohen si pjesë e saj.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

## **BFI TRADE SHPK**

### **Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

---

#### **4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

##### *ii) Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### *iii) Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë si më poshtë:

- Automjete	5 vjet
- Paisje kompjuterike	4 vjet
- Mobilje	5 vjet

Amortizimi i këtyre aktiveve do të fillojë kur ato të jenë të gatshme për përdorim, që do të thotë, kur ato të jenë në vendndodhjen dhe në kushtet e nevojshme për tu përdorur në mënyrën e synuar nga drejtimi. Përfitime të ardhshme ekonomike të ndërlydhura me objektin do t'i vijnë Shoqërisë përgjatë jetës së saj të zgjatur, dhe në këtë mënyrë shpenzimi kapitalizohet. Kur pjesë e një aktiviteti nuk konsiderohet në mënyrë të ndarë si një komponent, vlera e zëvendësimit përdoret për të parashikuar totalin e vlerës së aktivitetit që zëvendësohet i cili fshihet menjëherë nga pasqyrat financiare. Të gjitha shpenzimet e tjera për mirëmbajtjen, që ndodhin në përditshmëri shënohen si shpenzime në momentin që ndodhin.

Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale dhe çdo pjesë e rëndësishme e njohur në fillim, nuk njihet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit, ose kur nuk priten përfitime të ardhshme nga përdorimi ose nga shitja e tij.

##### **g. Komisionet nga kontratat me klientë**

Shoqëria ka vlerësuar se plotëson kushtet për tu trajtuar si agjent në kontratat e saj me klientët.

Kur Shoqëria agjent plotëson një kusht performance, ajo i njej të ardhurat në formën e tarifës ose komisionit që pret të ketë të drejtë në këmbim të tregtimit të mineralit ndaj palës tjetër.

Të ardhurat nga kontrata e shitjes me klientin për komisione është shuma neto koresponduese që Shoqëria mban pasi i paguan palës tjetër shumën koresponduese të marrë në këmbim të mineralit që ofrohen nga ajo palë.

**4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)****h. Të ardhurat nga kontratat me klientët për komisionet****Shitja e mineralit**

Shoqëria ka aktivitet kryesor shitjen e mineralit të kromit. Megjithëse gjithë të ardhurat gjatë vitit janë gjeneruar nga kontratat ku Shoqëria nuk është furnitor kryesor por agjent, Shoqëria mund të hyjë në kontrata me palë të tjera ku mund të luajë dhe rolin kryesor në transaksion.

Në kontrata si kryesor, njohja e të ardhurave nga shitja e mineralit njihet kur rreziqet dhe përfitimet nga pronësia i janë transferuar klientit, rimarrja e shumës është e mundshme, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. E ardhura njihet me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose për tu marrë, neto nga kthimet. Për shitjet e mineralit të kromit, aktualisht transferimi ndodh kur sasia aktuale e mineralit merret në dorëzim nga klienti dhe klienti nuk ka kundërshtime lidhur me cilësinë, franksionimin apo sasinë e mineralit sipas të cilës kanë rënë dakort palët në kontratë.

Shoqëria konsideron se nuk ka premtime të tjera në kontratë që janë detyrime të performancës të cilat janë të detyrueshme për tu përmbushur.

**Llogaritë e arkëtueshme**

Një e arkëtueshme përfaqëson të drejtën e Shoqërisë për një shumë të konsiderueshme që është e pakushtëzuar referuar politikave kontabël të aktiveve financiare në seksionin b) Instrumentet financiarë njohja fillestare dhe matja e mëvonshme.

**i. Qiratë**

Shoqëria vlerëson në fillim të cdo kontrate nëse është apo përmban një qira. Kjo ndodh në rastet kur një kontratë përcjell të drejtën për të kontrolluar një aktiv të identifikueshëm për një periudhë kohe në këmbim të një shume. Shoqëria përdor një qasje të vetme në njohjen dhe matjen e të gjitha qirave, me përjashtim të qirave afatshkurtra dhe atyre për të cilat aktivi bazë është me vlerë të ulët.

*Aktiv me të drejtë përdorimi*

Shoqëria njuh një aktiv me të drejtë përdorimi në datën e fillimit të qirasë (p.sh. data kur aktivi është i gatshëm për përdorim). Aktivi me të drejtë përdorimi matet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi dhe ndonjë korrigjim për rimatjet e detyrimit të qirasë. Kosto e aktivit me të drejtë përdorimi përfshin detyrimin e qirasë së njohur, kostot direkte dhe pagesat e qirasë të bëra në/përpara datës së fillimit, minus ndonjë stimul qiraje të marrë. Aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet me metodën lineare për periudhën më të shkurtër midis kohëzgjatjes së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

*ii) Detyrimi i qirasë*

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njuh një detyrim të qirasë së matur me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të cilat nuk janë paguar ende në atë datë. Pagesat, përfshijnë pagesat fikse minus ndonjë stimul qiraje të marrë, pagesat e ndryshueshme të qirasë që varen nga ndonjë indeks apo normë e matur fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit, dhe vlerat e pritshme për tu paguar nga qiramarrësi sipas vlerës së mbetur të garancive.

Gjithashtu pagesat e qirasë përfshijnë cmimin e ushtrimt të një opsioni blerjeje nëse qiramarrësi ka siguri të arsyeshme për të ushtruar atë opsion.

**4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)****i. Qiratë (vazhdim)**

Pagesat e qirasë duhet të skontohehen duke përdorur normën e interesit të përcaktuar të qirasë, nëse kjo norme mund të përcaktohet lehtë. Nëse kjo norme nuk mund të përcaktohet lehtë, qiramarrësi duhet të përdorë normën rritëse të huamarrjes të qiramarrësit. Detyrimet e qirasë përfshihen si huamarrje me interes.

*iii) Qiratë afatshkurtra dhe qiratë me vlerë të ulët*

Shoqëria aplikon përjashtimin e njohjes së qirave afatshkurtra për qiratë e apartamenteve dhe paisjeve (psh. qiratë me afat maturimi më të vogël se 12 muaj nga data e fillimit dhe që nuk përmbajnë opsionin e blerjes). Gjithashtu aplikohet përjashtimi për njohjen e qirave me vlerë të ulët (p.sh. paisjet e zyrës). Pagesat e qirasë për qiratë afatshkurtra dhe qiratë me vlerë të ulët janë njohur si shpenzim me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së qirasë.

*iv) Shoqëria si qiramarrëse*

Qiratë në të cilat Shoqëria nuk merr përsipër të gjitha risqet dhe përfitimet e lidhura me përdorimin e aktivitetit janë klasifikuar si qira operacionale. Shpenzimet nga qiraja kontabilizohen me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së qirasë dhe përfshihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas natyrës së operacionit. Kostot fillestare direkte gjatë negociimit dhe caktimit të një qiraje operacionale i shtohen vlerës kontabël të aktivitetit të marrë me qira dhe njihen përgjatë jetëgjatësisë së qirasë sipas së njëjtës metode.

Shoqëria ka vlerësuar se ka vetëm një marrëveshje të qirasë e cila bie nën qëllimin e trajtimit të IFRS-16. Kontrata për qiranë e përdorimit të automjetit.

Shoqëria gjithashtu ka përdorur:

- Një normë të vetme skontimi për të gjithë portofolin e qirave me karakteristika të njejta. Norma skontuese e interesit të përdorur është aprovuar në bazë të përqindjes së kostos së huamarrjes në nivel grupi sipas cdo periudhe kohëzgjatje kontrate.
- Ka aplikuar përjashtimin për qiratë afatshkurtra me afat që përfundon brenda 12 muajve nga data e aplikimit.
- Vlerësimin në përcaktimin e afatit të qirasë ku kontrata përmban opsionin e shtyrjes ose përfundim të saj.

**j. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë fitimet nga kursi i këmbimit dhe të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare (nëse ka).

Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet nga kursi i këmbimit, shpenzimet e interesit për huatë, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare nëpërmjet fitimit dhe humbjes dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare (nëse ka).

**4. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)****k. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi përbëhet nga taksa aktuale dhe e shtyrë. Shpenzimi i tatim fitimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveçse në rastet kur lidhet me elementë që njihen direkte në kapital, në të cilat njihet direkte në kapital. Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e pasqyrave të pozicionit financiar, duke rezultuar në diferencë të përkohshme ndërmjet vlerës së mbartur të aktiveve dhe pasiveve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që priten të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur anulohen, bazuar në legjislacionin që ka qenë në fuqi ose ka hyrë në fuqi në fund të periudhës së raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që është e mundur që përfitimet e ardhshme të taksueshme do të jenë të vlefshme ndaj diferencave të përkohshme që mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimet e lidhura me atë tatim do të realizohen.

**l. Taksat mbi shitjet**

Kur taksa mbi shitjet e cila vendoset në blerjen e aktiveve ose shërbimeve nuk është e kreditueshme nga autoritetet tatimore në këtë rast, ajo është e njohur si pjesë e kostos së blerjes së aktiveve ose si pjesë e mjeteve shpenzuese. Shoqëria është subjekt i pagesës së rentës minerare.

Renta minerare është taksa që paguan çdo person fizik ose juridik, i cili është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me Ministrin përgjegjës për ekonominë. Këto subjekte duhet të paguajnë qira për burimet natyrore të nxjerra nga, mbi dhe nën tokën e Republikës së Shqipërisë. Renta minerare llogaritet si një detyrim mujor i tatimpaguesit, në kohën kur ai shet produkte minerale.

**5. STANDARTET E REJA DHE AMENDIMET E HYRA NË FUQI**

**Standardet e reja efektive për periudhën nga 1 Janari 2021**

***Standardet e reja dhe ato të ndryshuara efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 Janar 2021 dhe që nuk kanë ndonjë efekt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë:***

- COVID-19- Koncesionet e Lidhura me Qiranë (Përditësime të SNRF 16), data efektive 1 qershor 2020;
- Reforma e Normës së Interesit Referuese – Faza 2 (Përditësime të SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16), data efektive 1 Janar 2021;
- COVID-19- Koncesionet e Lidhura me Qiranë përtej 30 Qershorit 2021 (Përditësime të SNRF 16), data efektive 1 Prill 2021;

***Standardet e reja që mund të adoptohen më herët:***

- Klasifikimi i Detyrimeve si afatshkurtra dhe afatgjata (Përditësime të SNK 1), data efektive 1 Janar 2022;
- Përmirësime Vjetore në SNRF 2018–2020, data efektive 1 Janar 2022;
- Aktivet afatgjata materiale: Shitjet përpara përdorimit (Përditësime të SNK 16), data efektive 1 Janar 2022;
- Referenca në Kuadrin Konceptual (Përditësime të SNRF 3), data efektive 1 Janar 2022;
- Klasifikimi i Detyrimeve si afatshkurtra dhe afatgjata (Përditësime të SNK 1), data efektive 1 Janar 2023;
- SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve dhe përditësimet në SNRF 17, data efektive 1 Janar 2023;
- Shënimet shpjeguese të politikave kontabël (Përditësimet në SNK 1 dhe shënimi praktik 2 në SNRF), data efektive 1 Janar 2023;
- Përkufizimi i vlerësimeve kontabël (Përditësime të SNK 8), data efektive 1 Janar 2023;
- Tatimi i shtyrë që lidhet me Aktivet dhe Detyrimet që vijnë si pasojë e një Transaksioni të Vetëm (Përditësime të SNK 12), data efektive 1 Janar 2023;

***Standardet e reja të gatshme për adoptim opsional / data efektive është shtyrë pafundësisht***

- Shitja ose Kontributi në asete ndërmjet një investitori dhe shoqërisë së asociuar të tij ose shoqërisë së përbashkët (Përditësime në SNRF 10 dhe SNK 28)

## **BFI TRADE SHPK**

### **Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

#### **6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR**

Shoqëria ka analizuar rreziqet e mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë,
- rreziku i likuiditetit,dhe
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe menaxhimin e rrezikut dhe menaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

#### **Rreziku i kredisë**

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare për Shoqërinë nëse një klient ose palë tjetër nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe vjen kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme dhe të drejtat ndaj Grupit të Shoqërisë.

Vlera e mbartur e aktiveve financiare paraqet maksimumin e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë.

Maksimumi i ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është paraqitur më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>Më 31 dhjetor 2020</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	10,908,605	1,588,480
Mjete monetare të ngurtësuara	5,701,330	4,474,099
Të drejta të arkëtueshme tregtare	195,033,925	2,291,706
<b>Totali</b>	<b>211,643,860</b>	<b>8,354,285</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	15,587,338	5,115,878
<b>Totali i detyrimeve afatshkurta</b>	<b>15,587,338</b>	<b>5,115,878</b>

**BFI TRADE SHPK****Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021***(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)***7. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të mos jetë në gjëndje të përmbushë detyrimet e saj në kohën e maturimit të tyre. Mënyra që ndjek Shoqëria në drejtimin e rrezikut të likuiditetit është të sigurojë se do të ketë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj në kohë, në kushte normale dhe të vështira, pa shkaktuar humbje të papranueshme dhe pa rrezikuar reputacionin e Shoqërisë.

Shoqëria gjeneron rrjedhje parash të konsiderueshme nga aktivitetet e saj operative në masën që ajo beson që rreziku i saj i likuiditetit është i pakonsiderueshëm.

**Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit**

Aktivitet dhe detyrimet financiare, sipas maturitetit kontraktual janë detajuar më poshtë:

	31 dhjetor 2021				
	deri në 1 muaj	2 deri në 3 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
<b>AKTIVE</b>					
Mjete monetare dhe ekuivalentë	10,908,605	-	-	-	<b>10,908,605</b>
Mjete monetare të ngurtësuara	-	-	-	5,701,330	<b>5,701,330</b>
Të drejta të arkëtueshme tregtare	195,033,925	-	-	-	<b>195,033,925</b>
<b>TOTAL AKTIVE</b>	<b>205,942,530</b>	-	-	<b>5,701,330</b>	<b>211,643,860</b>

**DETYRIMET**

Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	-	11,330,471	-	4,256,867	<b>15,587,338</b>
<b>Total detyrimet</b>	-	<b>11,330,471</b>	-	<b>4,256,867</b>	<b>15,587,338</b>
<b>Hendeku i Likuiditetit</b>	<b>205,942,530</b>	<b>(11,330,471)</b>	-	<b>1,444,463</b>	<b>196,056,522</b>

	31 dhjetor 2020				
	deri në 1 muaj	Me pak se 3 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
<b>AKTIVE</b>					
Mjete monetare dhe ekuivalentë	1,588,480	-	-	-	<b>1,588,480</b>
Mjete monetare të ngurtësuara	-	-	-	4,474,099	<b>4,474,099</b>
Të drejta të arkëtueshme tregtare	-	2,291,706	-	-	<b>2,291,706</b>
<b>TOTAL AKTIVE</b>	<b>1,588,480</b>	<b>2,291,706</b>	-	<b>4,474,099</b>	<b>8,354,285</b>

**DETYRIMET**

Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	-	-	5,115,878	-	<b>5,115,878</b>
<b>TOTAL DETYRIMET</b>	-	-	<b>5,115,878</b>	-	<b>5,115,878</b>
<b>Hendeku i Likuiditetit</b>	<b>1,588,480</b>	<b>2,291,706</b>	<b>(5,115,878)</b>	<b>4,474,099</b>	<b>3,238,407</b>

**BFI TRADE SHPK****Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021***(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)***7. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë tek të ardhurat e Shoqërisë. Objektivi i drejtimit të rrezikut të tregut është të kontrollojë se ekspozimet e tregut janë brenda parametrave të pranueshëm duke optimizuar kthimin.

*Rreziku i normave të interesit*

Shoqëria nuk përballet me rrezikun e normës së interesit pasi nuk ka huamarrje në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

*Rreziku i kursit të këmbimit*

Shoqëria nuk përballet me rreziqe të rëndësishme të kursit të këmbimit nga veprimtaria normale. Kjo pasi kompania ka sinkronizuar termat e pagesave mes klientëve dhe furnitorëve. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga ky rrezik.

AKTIVE	31 dhjetor 2021			
	Lek	Euro	Usd	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalentë	3,745,316	165,046	6,998,243	<b>10,908,605</b>
Mjete monetare të ngurtësuar	5,701,330	-	-	<b>5,701,330</b>
Të drejta të arkëtueshme tregtare	-	-	195,033,925	<b>195,033,925</b>
<b>TOTAL AKTIVE</b>	<b>9,446,646</b>	<b>165,046</b>	<b>202,032,168</b>	<b>211,643,860</b>

DETYRIMET	31 dhjetor 2021			
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	19,918	79,702	15,487,718	<b>15,587,338</b>
<b>TOTAL DETYRIMET</b>	<b>19,918</b>	<b>79,702</b>	<b>15,487,718</b>	<b>15,587,338</b>
<b>Hendeku i Likuiditetit</b>	<b>9,426,728</b>	<b>85,344</b>	<b>186,544,450</b>	<b>196,056,522</b>

AKTIVE	31 dhjetor 2020			
	Lek	Euro	Usd	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalentë	592,065	865,278	131,137	<b>1,588,480</b>
Mjete monetare të ngurtësuar	4,474,099	-	-	<b>4,474,099</b>
Të drejta të arkëtueshme tregtare	-	-	2,291,706	<b>2,291,706</b>
<b>TOTAL AKTIVE</b>	<b>5,066,164</b>	<b>865,278</b>	<b>2,422,843</b>	<b>8,354,285</b>
DETYRIMET	31 dhjetor 2020			
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	94,109	843,881	4,177,888	<b>5,115,878</b>
<b>TOTAL DETYRIMET</b>	<b>94,109</b>	<b>843,881</b>	<b>4,177,888</b>	<b>5,115,878</b>
<b>Hendeku i Likuiditetit</b>	<b>4,972,055</b>	<b>21,397</b>	<b>(1,755,045)</b>	<b>3,238,407</b>

*Analiza e ndjeshmërisë*

Me anën e menaxhimit të rrezikut të kursit të këmbimit, Shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në një periudhë afatgjatë, sidoqoftë, ndryshimet e vazhdueshme në kurset e këmbimit mund të kenë një ndikim në fitim. Më 31 dhjetor 2021 është vlerësuar se një ndryshim në përqindjen e kursit të këmbimit në vlerën e Lek-ut kundrejt monedhes Euro me +/- 5% do sillte një ndryshim prej 4,267 Lek, (2020: 1,070 Lek) në fitimin e Shoqërisë para tatimit mbi fitimin. Një ndryshim në përqindjen e kursit të këmbimit në vlerën e Lek-ut kundrejt monedhes USD me +/- 5% do sillte një ndryshim prej 9,327,223 Lek (2020: (87,752) Lek) në fitimin e Shoqërisë para tatimit mbi fitimin.

**BFI TRADE SHPK****Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021***(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)***8. MJETE MONETARE**

Paraja në arkë dhe bankë në pasqyrën e Pozicionit Financiar paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
<b>Vlera në arkë</b>	<b>17,520</b>	<b>28,421</b>
Arka në leke	10,040	20,759
Arka në euro	7,480	7,662
<b>Vlera në banka</b>	<b>10,891,085</b>	<b>1,560,059</b>
Llogari rrjedhëse në lekë	3,735,276	571,306
Llogari rrjedhëse në Usd	6,998,243	131,137
Llogari rrjedhëse në Euro	157,566	857,616
<b>Totali</b>	<b>10,908,605</b>	<b>1,588,480</b>

Mjetet monetare të ngurtësuara në pasqyrën e Pozicionit Financiar paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Mjete monetare të ngurtësuara	5,701,330	4,474,099
<b>Totali</b>	<b>5,701,330</b>	<b>4,474,099</b>

Shoqëria më 31.12.2021 ka kufizime në disa llogari pranë Raiffeisen bank vendosur nga përmbartuesi gjyqësor Brahim Muca për detyrimet ligjore që shoqëria ka ndaj Shoqërisë “Besjana shpk” në shumën prej 2,557,096 Lekë dhe ndaj Shoqërisë “Global Interprise Group shpk” në shumën prej 3,144,234 Lekë.

**9. TË DREJTA TË ARKËTUESHME TREGTARE**

Llogaria të Drejta të arkëtueshme në pasqyrën e Pozicionit Financiar paraqitet si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Te arkëtueshme nga njësitë ekonomike	195,033,925	2,291,706
<b>Totali</b>	<b>195,033,925</b>	<b>2,291,706</b>

Llogaritë e arkëtueshme tregtare nuk mbartin interes dhe në përgjithësi janë të pagueshme brenda harkut kohor 30 ditë. Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 Shoqëria nuk ka njohur një provigjon për të drejtat e arkëtueshme pasi nuk parashikon të ketë risk likuiditeti. Kjo për faktin pasi klienti kryesor i kompanisë ka qenë palë e lidhur. Termat e likuidimeve sipas kontratës me klientë janë mbyllja e detyrimeve kontraktuale brenda 30 ditësh nga data e lëshimit të faturës.

Shoqëria në 31 Dhjetor 2021 ka gjendje klientë prej 195,033,925 Leke (2020: 2,291,706 Leke), gjendje që i përket klientit të saj kryesor Albchrome shpk, i cili për vitin 2020 ka qenë palë e lidhur. Duke qenë se aktiviteti i Shoqërisë BFI Trade është përqëndruar kryesisht në klientin e saj kryesor Albchrome shpk, i cili me anë të vendimit të Asamblesë së Ortakëve i datës 15.10.2021, ka vendosur, miratimin e shitjes së 100% të kuotës nga “Balfin - Balkan Finance Investment Group”, te shoqëria “Yldirim International Mining Investments B.V.” Transaksioni i shitjes është realizuar dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më 28 janar 2022. Kështu që tashmë Albchrome shpk, nuk është më palë e lidhur me Shoqërinë BFI Trade, kjo shumë është paguar në datën 11.01.2022 në vlerën e plotë, e për këtë arsye Shoqëria ka vlerësuar se nuk ka tregues për zhvlerësim në lidhje me të arkëtueshmet ndaj klientit të saj më 31 dhjetor 2021.

**BFI TRADE SHPK****Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021***(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)***10. PARAPAGIME DHE TË TJERA AFATSHKURTRA**

Parapagime dhe të tjera afatshkurtra në pasqyrën e Pozicionit Financiar paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Parapagime dhe të tjera afatshkurtra me pale të treta	-	165,265
Shpenzime të shtyra me palë të lidhura	-	72,172
Shpenzime të shtyra	-	33,353
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>270,790</b>

**11. TË DREJTA TË TJERA TATIMORE**

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Të drejta tatimore për tatim fitimin	4,674,870	40,000,394
Të drejta tatimore për tatimin mbi të ardhurat personale	3,587	-
Të drejta tatimore për tatimin mbi vlerën e shtuar	-	757,159
<b>Totali</b>	<b>4,678,457</b>	<b>40,757,553</b>

Në zërin të drejta të tjera tatimore për tatim fitimin në pasqyrën e pozicionit financiar janë përfshirë të drejtat e Shoqërisë ndaj organeve tatimore për parapagimet e kësteve të tatim fitimit dhe parapagime për tatime të tjera. (Shih shënimin 27).

**12. AKTIVE MATERIALE TË MBAJTURA PËR SHITJE**

Shoqëria nuk ka aktive të vendosura si kolateral më 31 dhjetor 2021 dhe të gjitha aktivet janë të lira nga pengesat. Drejtimi ka vlerësuar në datën e raportimit duke u bazuar në planet e zhvillimit, që nuk ka tregues të rënies në vlerë, dhe flukset monetare të ardhshme do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar vlerën kontabël të aktiveve të Shoqërisë.

Aktivet materiale në pasqyrën e Pozicionit Financiar paraqiten si më poshtë:

	<b>Pajisje Informatike</b>	<b>Totali</b>
<b><i>Kosto:</i></b>		
<b>Më 1 janar 2020</b>	<b>112,484</b>	<b>112,484</b>
Shtesa	100,000	100,000
Shitje	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>212,484</b>	<b>212,484</b>
Shtesa	-	-
Shitje	(174,992)	(174,992)
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>37,492</b>	<b>37,492</b>
<b><i>Amortizimi i akumuluar:</i></b>		
<b>Më 1 janar 2020</b>	<b>27,047</b>	<b>27,047</b>
Amortizimi për vitin	33,461	33,461
<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>60,508</b>	<b>60,508</b>
Amortizimi për vitin	33,156	33,156
Pakesime/shitje	(70,920)	(70,920)
<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>22,744</b>	<b>22,744</b>
<b><i>Vlera kontabël neto:</i></b>		
<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>151,976</b>	<b>151,976</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>14,748</b>	<b>14,748</b>

**BFI TRADE SHPK****Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021***(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)***13. AKTIVE ME TE DREJTE PERDORIMI**

Aktivitet me te drejte perdorimi përfaqësojnë qiratë operacionale të Shoqërisë si qiramarrëse, ku është njohur e drejta e përdorimit të aktivitet dhe detyrimi i qirasë për gjithë jetëgjatësinë e saj.

<b>Aktiv me te drejtë përdorimi</b>	<b>Automjete</b>	<b>Total</b>
<b>Më 1 janar 2020</b>	<b>2,519,821</b>	<b>2,519,821</b>
Shtesat	-	-
Amortizimi	(687,224)	(687,224)
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>1,832,597</b>	<b>1,832,597</b>
Pakesimet	(3,207,045)	(3,207,045)
Amortizimi	(629,955)	(629,955)
Pakesim i amortizimit	2,004,403	2,004,403
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

<b>Detyrimi i qirasë</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
<b>Më 1 janar</b>	<b>1,826,482</b>	<b>2,491,761</b>
Shtesat/ (Pakesimet)	(1,143,164)	-
Interesi I përlllogaritur	43,762	70,425
Pagesat	(703,776)	(778,402)
Efekti nga kursi këmbimit	(23,304)	42,698
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>1,826,482</b>
Detyrim i qirasë afatshkurtër	-	761,792
Detyrim i qirasë afatgjatë	-	1,064,690
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>1,826,482</b>

**14. TË PAGUESHME TREGTARE**

Llogaritë e pagueshme prej 15,587,338 Lekë (2020: 5,115,878 Lekë) përfaqësojnë detyrimet ndaj subjekteve furnizuese të mineralit të Kromit. Llogaritë e të pagueshmeve tregtare përmbajnë detyrimet ndaj shoqërisë “Besjana shpk” në vlerën 1,882,682 Lek dhe “Global Interprise Group shpk” në vlerën 2,374,682 Lek). Për më shumë detaje shih shënimin 28.

**15. TË PAGUESHME PËR DETYRIME TATIMORE**

Të pagueshme për detyrimet tatimore në pasqyrën e Pozicionit Financiar paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
TVSH e pagueshme, neto	470,246	
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore të pagueshme	21,926	45,453
Tatimi mbi të ardhurat personale	-	34,573
<b>Totali</b>	<b>492,172</b>	<b>80,026</b>

**16. TË PAGUESHME TË TJERA**

Shoqëria ka përlllogaritur shpenzimet për shpenzime telefonie dhe shpenzime për shërbime auditimi të pasqyrave financiare, në bazë të kontratave dhe historikut të transaksioneve. Në vitin 2021 “Të pagueshme të tjera” janë në shumën 291,718 Leke (31 dhjetor 2020: 259,887 Leke), nga të cilat 8,301 Lek (31 dhjetor 2020: 3,335 Lek) janë paga dhe të tjera të pagueshme për punonjësit.

**BFI TRADE SHPK****Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021***(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)***17. DIVIDEND PËR TU PAGUAR**

Divident për tu paguar në shumën 64,344,000 Lekë (2020: 54,355,007) është pasqyruar detyrimi që Shoqëria ka ndaj Ortakut të saj "Balfin" shpk duke u netuar me pagesat e bera gjatë vitit ushtrimor.

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Divident të deklaruar për vitin ushtrimor paraardhës	54,355,007	169,530,940
Dividentë të deklaruar gjatë vitit	64,344,000	-
Dividentë të paguar gjatë vitit	(54,355,007)	(115,175,933)
<b>Totali</b>	<b>64,344,000</b>	<b>54,355,007</b>

**18. KAPITALI I NËNSHKRUAR**

Kapitali i nënshkruar më 31 dhjetor 2021 është 1.000 Lek i ndarë në 1 kuotë me vlerë 1.000 Lek. Në 31 dhjetor 2021 Shoqëria BALFIN është aksioneri i vetëm i Shoqërisë BFI TRADE shpk me një pjesëmarrje 100%. Aksioneri i vetëm është mbajtësi i së drejtës për përfitimin e dividendëve të ardhshëm, nëse shpërndahen.

**19. TË ARDHURAT NGA KONTRATAT ME KLIENTËT PËR KOMISIONET**

Si rrjedhojë e zbatimit të SNRF Shoqëria i njeh të ardhurat në formën e të ardhurave nga komisionet e cila është vlera neto e shumës korresponduese që Shoqëria mban, pasi i paguan palës tjetër shumën korresponduese të marrë në këmbim të blerjes së mineralit që do të ofrohet nga ajo palë. Shumat e faturuara bruto nga kontratat me klientët për komisione janë detajuar si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Të ardhura nga kontratat e shitjes	1,636,597,698	65,685,460
Blerje mineral kromi	(1,386,288,765)	(59,997,348)
<b>Totali</b>	<b>250,308,933</b>	<b>5,688,112</b>

Të ardhurat nga kontratat e shitjes përfaqësojnë shitjen e mineralit të kromit ndaj palës së lidhur Albchrome shpk. Blerjet e Mineralit të Kromit nga të tretë dhe Renta minerare janë zëra të cilët lidhen me kostot direkte për blerjen e mineralit të kromit.

**20. TË ARDHURA TË TJERA**

Të ardhura të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Të ardhura të tjera me palët e lidhura	2,297,171	-
Të ardhura të tjera	916,667	-
<b>Totali</b>	<b>3,213,838</b>	<b>-</b>

Të ardhura të tjera me palët e lidhura përfaqësojnë të ardhura nga sherbimet e asistences logjistike në shumën 2,297,171 Lek (2020: zero). Të ardhurat e tjera përfaqësojnë rimbursime të shpenzimeve sipas kontratave, dhe rimbursime të shpenzimeve në shumën 916,667 (2020: zero).

**BFI TRADE SHPK****Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021***(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)***21. SHPENZIME TË TJERA SHFRYTËZIMI**

Shpenzime të tjera të shfrytëzimit në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Shpenzime konsulence	3,614,167	2,964,189
Qira	726,840	802,142
Shpenzime amortizimi i asetëve me të drejtë përdorimi	629,955	687,224
Shpenzime noteriale dhe ligjore	100,000	656,528
Të tjera	385,425	269,235
Shpenzime karburanti	208,620	170,460
Taksa dhe tarifa vendore	269,320	163,200
Shërbime bankare	392,313	140,678
Postare dhe telekomunikacioni	99,542	65,676
Shpenzime pritje dhe përfaqësimi	-	50,000
Shërbime të tjera	135,311	16,735
<b>Totali</b>	<b>6,561,493</b>	<b>5,986,067</b>

Në zërin shpenzime konsulence janë përfshirë shërbimet që ka marrë Shoqëria për konsulencë financiare, juridike gjatë zhvillimit të aktivitetit të saj si dhe shpenzimet e auditimit të pasqyrave financiare.

Në zërin pritje përfaqësimi janë përfshirë shpenzimet për sponsorizime dhe shpenzime të tjera për pritje përfaqësimi.

Në zërin shpenzime qiraje janë klasifikuar shpenzimet për qera zyra si dhe për qira sheshe magazinimi të cilat nuk janë pjesë e objektit të SNRF 16 pasi nuk plotësohen kushtet e kontrollit të këtyre asetëve.

Në zërin të tjera përfshihen shpenzime administrative si shpenzime noteriale, siguracione taksa, shpenzime kancelarie etj.

**22. SHPENZIME TË PERSONELIT**

Shpenzime të personelit në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Paga dhe shpërblime	6,350,918	3,463,683
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore	378,439	328,193
Shpenzime të tjera stafi	35,000	-
<b>Totali</b>	<b>6,764,357</b>	<b>3,791,876</b>

**23. TË ARDHURA FINANCIARE**

Të ardhurat financiare në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Të ardhura nga kurset e këmbimit	17,915,236	2,316,758
<b>Totali</b>	<b>17,915,236</b>	<b>2,316,758</b>

**24. SHPENZIME FINANCIARE**

Shpenzimet financiare në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Humbje nga kurset e këmbimit	12,473,799	8,393,288
Shpenzime interesa mbi detyrimet e qerasë	43,762	70,425
Shpenzime interesi për pagesa detyrime të prapambetura	-	832
<b>Totali</b>	<b>12,517,561</b>	<b>8,464,545</b>

**BFI TRADE SHPK****Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021***(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)***25. TATIM FITIMI**

Shpenzimi i tatim fitimit i llogaritur për vitin ushtrimor 2021 bazohet në detyrimin për tatim fitimin sipas Legjislacionit Fiskal në Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15%. Niveli i taksimit për fitimin zbatuar në vitin paraardhës 2020 ka qenë 15%. Shoqëria ka kryer përgjatë vitit pagesat e kësteve të tatim fitimit në bazë të kësteve të përlllogaritur nga organi tatimor dhe si rrjedhojë, tatimi mbi fitimin i parapaguar, kompensohet nga shpenzimi për tatimin mbi fitimin. Rakordimi i shpenzimeve të tatimit të fitimit llogaritur me normën e tatimit ligjor mbi fitimin nga aktivitetet operative për Shoqërinë më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është paraqitur më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
(Humbja)/Fitimi para tatimit	245,561,440	(10,271,079)
Tatimi fillestar me 15%	36,834,216	(1,540,662)
Efekti tatimor i shpenzimeve që nuk janë të zbritshme për qëllime tatimore	13,398	18,572
Humbje tatimore të mbartura për periudhat pasardhëse	-	1,522,090
Humbje tatimore të perdorura të periudhave paraardhëse	(1,522,090)	-
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	<b>35,325,524</b>	<b>-</b>
	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Tatim fitimi i pagueshëm/(i arkëtueshëm) i mbartur nga viti paraardhës	(40,000,394)	(40,000,394)
Papapagime të tatim-fitimit për periudhën	-	-
Tatim fitimi i vitit	35,325,524	-
<b>Detyrime tatimore/(Të drejta tatimore) për tatim fitimin</b>	<b>(4,674,870)</b>	<b>(40,000,394)</b>

## **BFI TRADE SHPK**

### **Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

*(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)*

## **26. DETYRIME DHE ANGAZHIME TE TJERA**

### ***Çështje gjyqësore***

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta.

Në 4 dhjetor 2019, Shoqëria Besjana shpk ka bërë një kërkesë për shlyerje të menjëhershme detyrimit të BFI Trade Shpk për furnizimin me mineral kromi nëpërmjet 3 faturave në vlerën 17,667.38 USD (1,882,186 Lek). Në 30 dhjetor 2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat vendosi lëshimin e urdhërit ekzekutiv për shlyerjen e shumës 17,667.38 USD (1,882,186 Lek) nga BFI Trade Shpk, dhe shpenzime gjyqësore në shumën 50,000 Lekë. Në 19 qershor 2020, përmbauesi gjyqësor Privat Brahim Muca lajmëroi Shoqërinë për ekzekutimin vullnetar të detyrimit 17,667.38 USD, shpenzime gjyqësore 50,000 Lekë dhe tarifës përmbauesit prej 230,029 Lekë, ku më 08 korrik 2020 lëshoi urdhërin për vënien e masës së sekuestros konservative mbi llogaritë, depozitata dhe kreditë e debitorëve. Më 22 korrik 2020, është bërë kalimi i fondeve nga llogaria bankare e BFI Trade shpk drejt llogarisë së përmbauesit privat për vlerën 2,557,096 Lekë. Çështja po shqyrtohet sërish në Gjykatën e shkallës së pare në Mat.

Në 4 dhjetor 2019, Shoqëria Global Interprise Group ka bërë një kërkesë për shlyerje të menjëhershme të detyrimit në shumën 22,599 USD (2,374,682 Lekë) për detyrimin e BFI Trade Shpk lidhur me furnizimin me mineral kromi sipas kontratës Nr. 52/1 date 5.07.2018. Në 18 maj 2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat vendosi urdhrin e ekzekutimit mbi BFI Trade shpk për detyrimin 2,386,680 Lekë, shpenzime avokati në shumën 50,000 Lekë, shpenzime eksperti në shumën 24,000 Lekë dhe tarifën përmbauesit 268,768 Lekë. Në 5 gusht 2020 përmbauesi gjyqësor privat ka urdhëruar vënien e sekuestros konservative për shumën totale prej 3,142,450 Lekë. Në 7 gusht 2020, është bërë kalimi i pjesshëm i fondeve të gjendura në llogaritë e Shoqërisë prej 577,000 Lekë, 1,490 Euro dhe 11,000 USD drejt llogarisë së përmbauesit privat. Në vitin 2020, në mungesë të fondeve në llogari, nuk është bllokuar pjesa e mbetur prej 1,225,447 Lekë për shoqërinë "Global Interprise Group shpk". Gjate vitit 2021, është bërë kalimi i fondeve të gjendura në llogaritë e Shoqërisë prej 1,200 USD dhe 1,101,947 Lekë drejt llogarisë së përmbauesit privat. Shoqëria BFI Trade shpk ka apeluar çështjen në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe është në pritje të shqyrtimit të çështjes.

## **27. PALËT E LIDHURA**

Tabela e mëposhtme tregon shumat totale të transaksioneve në të cilat përfshihen palët e lidhura për vitin financiar përkatës:

<i>Balancat me palët e lidhura:</i>	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Të drejta të arkëtueshme nga Albchrome	195,033,926	2,363,878
Furnitor për mallra dhe shërbime me Balfin Group	-	-
Furnitor për mallra dhe shërbime me Vllahen Mining	-	-
Divident per tu paguar tek Balfin Group	(64,344,000)	(54,355,007)
Mjete Monetare me Tirana Bank	-	-
Parapagime dhe të tjera afatshkurtra me kompanitë motra	-	16,667

**BFI TRADE SHPK****Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021***(Vlerat janë shprehur në monedhën Lek)***27. PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)***Transaksionet me palët e lidhura:*

	<b>Për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2021</b>	<b>Për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2020</b>
<i>Shitje:</i>		
Të ardhura nga kontratat me Albchrome	(1,636,597,698)	(65,685,460)
Të ardhura nga kontratat me Neptun	(2,267,171)	
Të ardhura nga kontratat me AES	(30,000)	-
	<b>(1,638,894,869)</b>	<b>(65,685,460)</b>

	<b>Për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2021</b>	<b>Për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2020</b>
<i>Blerje:</i>		
Aktive afatgjata materiale nga Neptun Albania	-	100,000
Shërbime konsulence dhe të tjera shërbime me Balfin Group	2,784,736	2,811,563
Të tjera shërbime me Albchrome	916,667	
Të tjera shërbime me Fashion Group Albania	25,000	
Të tjera shërbime me Spar Albania	4,167	
Shpenzime qiraje me Albchrome	726,840	792,738
Shpenzime të tjera shfrytëzimi me Tirana Bank	13,118	14,946
	<b>4,470,528</b>	<b>3,719,247</b>

**28. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT**

Masat shtrënguesë për shkak të pandemisë Covid-19, vazhduan të jenë në fuqi edhe përgjatë muajve janar-mars 2022. Deri në datën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare kjo ngjarje është konsideruar si ngjarje jo me efekt rregullues për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2021.

Drejtimi i Shoqërisë nuk ka ndërmend të vazhdojë aktivitetin dhe dëshiron ta mbyllë Shoqërinë përgjatë vitit 2022. Shoqëria nuk ka kryer një test për zhvlerësimin në lidhje me vlerën e aktiveve të mbajtura për shitje, dhe nuk ka bërë ndonjë vlerësim të pavarur të këtyre aktiveve të mbajtura për shitje. Për këtë arsye, Shoqëria ka klasifikuar shumicën e aktiveve që më parë ishin njohur si aktive afatgjata materiale dhe jomateriale si aktive afatshkurtra dhe si aktive të mbajtura për shitje duke i njohur ato në vlerën e tyre të mbetur.

Shoqëria në 31 Dhjetor 2021 ka gjendje klientë prej 195,033,925 Leke (2020: 2,291,706 Leke), gjendje që i përket klientit të saj kryesor Albchrome shpk, i cili për vitin 2020 ka qenë palë e lidhur. Duke qenë se aktiviteti i Shoqërisë BFI Trade është përqëndruar kryesisht në klientin e saj kryesor Albchrome shpk, i cili me anë të vendimit të Asamblesë së Ortakëve i datës 15.10.2021, ka vendosur, miratimin e shitjes së 100% të kuotës nga “Balfin - Balkan Finance Investment Group”, te shoqëria “Yldirim International Mining Investments B.V.” Transaksioni i shitjes është realizuar dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më 28 janar 2022. Kështu që tashmë Albchrome shpk, nuk është më palë e lidhur me Shoqërinë BFI Trade, kjo shumë është paguar në datën 11.01.2022 në vlerën e plotë, e për këtë arsye Shoqëria ka vlerësuar se nuk ka tregues për zhvlerësim në lidhje me të arkëtueshmet ndaj klientit të saj më 31 dhjetor 2021.

Përveç sa më sipër, nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që mund të kërkojë rregullim apo pasqyrim të informacionit në pasqyrat financiare të Shoqërisë.